



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 12.3.2025

Nr: 262

Ora: 19:00

VENDIM

PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 238, DATË 4.3.2025, TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE “PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E KOALICIONIT “PARTIA DEMOKRATIKE-ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE”, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND, TË DATËS 11 MAJ 2025”

Sot, më datë 12.3.2025, mora në shqyrtim kërkesat me nr. 1737 prot., datë 11.3.2025 dhe nr. 1334/1 prot., datë 10.3.2025, me:

KËRKUES:

1. Subjekti zgjedhor “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europian” (AMIE)”, me Kryetar Z. Vasil Sterjovski;
2. Partia Politike “Aleanca Konservatore për Shqipërinë”, me kryetar Z. Altin Goxhaj

OBJEKTI:

1. Çregjistrimin e subjektit zgjedhor “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europian”, nga Koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore” për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025;
2. Ndryshimin e të dhënave të Partisë “Aleanca Europiane Ekologjike”, (AEE) në “Aleanca Konservatore për Shqipërinë” (AKPSH) dhe të zëvendësimit të kryetarit z. Sazan Guri me kryetarin z. Altin Goxhaj, sipas vërtetimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

BAZA LIGJORE:

Neni 65, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligji nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për Partitë Politike”, i ndryshuar,

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

Data: 12.3.2025 Nr: 262
Ora: 19:00



Për disa ndryshime në vendimin nr. 238, datë 4.3.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për shqyrtimin e kërkesës së koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore” me shkronja nistore “PD-ASHM” për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”

V Ë R E J:

I.

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, ka caktuar datën 11 Maj 2025, për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

Me vendimin nr. 163, datë 25.2.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi regjistrimin e partisë politike Partia “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europian”, me kryetar Z. Vasil Sterjovski, me shkronjat nistore “A.M.I.E”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025.

Subjekti zgjedhor “Partia Demokratike”, nëpërmjet Kryetarit, Z. Sali Berisha, brenda afatit të ligjor të përcaktuar ka paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën me nr. 1547 prot., datë 3.3.2025, për regjistrimin e koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025.

Bashkëlidhur kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore” ka depozituar marrëveshjen e nënshkruar nga kryetarët e partive politike pjesëmarrëse në këtë koalicion, pjesë e së cilës është dhe subjekti zgjedhor “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europian” (AMIE), me kryetar Z. Vasil Sterjovski.

Me vendimin nr. 238, datë 4.3.2025, Komisioneri Shtetëror Zgjedhjeve vendosi regjistrimin e Koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore”, përfaqësuar nga Z. Sali Berisha, me shkronja nistore “PD-ASHM”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025.

Me kërkesën nr. 1737 prot, datë 11.3.2025, subjekti zgjedhor Partia “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europian” (AMIE), me kryetar Z. Vasil Sterjovski ka kërkuar çregjistrimin nga Koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore”, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025.

II.

Referuar vendimit nr. 238, datë 4.3.2025, Komisioneri Shtetëror Zgjedhjeve, parti politike pjesëmarrëse e koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore” është dhe subjekti zgjedhor “Aleanca Europiane Ekologjike”, me initiale “AEE”, me Kryetar Z. Sazan Guri.

Në datë 10.3.2025, z. Altin Goxhaj ka depozituar kërkesën nr. 1334/1prot., me objekt ndryshimin e të dhënave të Partisë “Aleanca Europiane Ekologjike” në “Aleanca Konservatore për Shqipërinë” dhe të zëvendësimit të kryetarit z. Sazan Guri me kryetarin z. Altin Goxhaj, sipas vërtetimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vendimi nr. 8, datë 21.2.2025, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me anë të cilit është vendosur “Ndryshimi i emrit të partisë, nga “Partia Aleanca Europiane Ekologjike”, “AEE” në “Aleanca Konservatore për Shqipërinë”, me akronimin “AKPSH”.

Data: 12.3.2025 Nr: 262
Ora: 19:00



Për disa ndryshime në vendimin nr. 238, datë 4.3.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për shqyrtimin e kërkesës së koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore” me shkronja nistore “PD-ASHM” për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”

- b) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 11.3.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se: “Me vendimin nr. 8, datë 21.2.2025, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është vendosur “Ndryshimi i emrit të partisë, nga “Partia Aleanca Europiane Ekologjike” në “Aleanca Konservatore për Shqipërinë”, me akronimin “AKPSH” dhe kryetar të partisë z. Altin Goxhaj”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, nenet 64, 65 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për Partitë Politike”, i ndryshuar,

V E N D O S :

1. Çregjistrimin e subjektit zgjedhor partia “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europian” (AMIE), me kryetar z. Vasil Sterjovski, nga Koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore” .
2. Ndryshimin e të dhënave të subjektit zgjedhor Partia “Aleanca Europiane Ekologjike”, me kryetar Z. Sazan Guri, në Partia “Aleanca Konservatore për Shqipërinë”, “AKPSH”, me kryetar z. Altin Goxhaj, si parti politike pjesëmarrëse e Koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore” për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI